

Njoftim

Sot, më datë **18.04.2023**, ora **16:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Emona Muçi (Relatore);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 4. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare).**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, salla 2, pasi shqyrtoi çështjen Nr.12 Regj.Themeltar, Datë 12.04.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Subjekti Zgjedhor Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), e përfaqësuar në seancë nga z. Vebi Hana.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Objekti:

1. Kundërshtimin e Vendimit nr.49, datë 06.04.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.
2. Ndryshimin e këtij Vendimi duke regjistruar z. Vebi Tahir Hana, si kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas, i propozuar nga Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 01, datë 23.12.2020 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

me Vendimin Nr.12, datë 18.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesëpadisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

4. U shpall në Tiranë më datë 18.04.2023.

Tiranë, më 18.04.2023.

Gjykata Administrative e Apelit